

Zyrtarja për Barazi Gjinore



Raport Janar – Dhjetor 2020

Malishevë 2021



Republika e Kosovës
Komuna e Malishevës




Datë: 06.01.2021

Nr. 01/03

Zyra për Barazi Gjinore ka realizuar një sërë aktivitete për të promovuar barazinë gjinore, të drejtat e grave në jetën shoqërore, sociale e politike.

Realizimi i ligjëratave, punëtorive duke përfshirë grupe të grave dhe nxënës nëpër të gjitha shkollat, me tema të ndryshme duke filluar nga të drejtat e njeriut me theks të veçantë të drejtat e fëmijëve, kundër-trafikut, kundër dhunës në familje, barazia gjinore në familje e shoqëri, shpërnadrje të fletëpalosjeve me tematika të ndryshme të cilat kanë ndikuar në sensibilizim dhe vetëdijësim.



Takimi i parë u realizua me grupin e grave, komitetin për Barazi Gjinore, OJQ-të aktive, dhe bashkëpunëtorë, për raportin e punës, planifikimin dhe realizimin e aktiviteteve të ndryshme përgjatë vitit, duke përfshirë: arsimimin, shëndetësinë, vendim-marrjen, mirëqenjen, biznesin



Takimi i radhës u mbajt me disa nga anëtarët e grupit të grave, KBGJ dhe shoqërisë civile për ndarjen e mirënjohjeve për gratë kontribut-dhënëse përgjatë viteve.

Familje të dëshmorëve, arsimim, të drejta të Grave dhe Fëmijëve (QMGF – dy),kontribut të dhënë gjatë luftës, shëndetësi,post-mortum, biznes, të cilat ndahen me rastin e festës ndërkombëtare të gruas.



Takim me kryetarin e Komunës lidhur me shpalljen e Javës për Barazi Gjinore dhe aktivitetet të cilat do të mbahen përgjatë kësaj jave – përgjatë javës u mbajtën aktivitetet në të gjitha shkollat – ese, ekspozita, diskutime me temën - ***barazia gjinore hap i sigurtë në shoqëri.***

Për vendin e parë, të dytë dhe të tretë u ndanë mirënjohje.

Java e Barazisë Gjinore





Janë njoftuar të gjitha shkollat fillore dhe të mesme të Komunës tonë që një orë mësimore t'i kushtohet Barazisë Gjinore dhe historikut të tetë Marsit, ligjërata të realizohet nga mësimdhënësit e Edukatës Qytetare dhe Historisë dhe ZBGJ.

Është shpallur Java për Barazi Gjinore përmes web-faqes dhe është njoftuar Kryetari i Komunës me aktivitetet të cilat do të realizohen gjatë kësaj jave.

Punëtori – nxënësit kanë paraqitur Barazinë Gjinore përmes punimeve të ndryshme se si e shohin barazinë nga kënd-vështrimi i tyre – janë ndarë mirënjohje për vendin e parë, dytë dhe tretë.


Punëtori – nxënësit kanë paraqitur dallimet gjinore përmes shkrimeve të tyre-janë ndarë mirënjohje për vendin e parë, dytë dhe tretë.

Ndarja e mirënjohjeve për gratë që kanë kontribuar ndër vite (vlerësuar nga komisioni)

Vendosja e kurorave në varrin e Nexhmije Pagarushës

Vendosja e kurorave pranë lapidarit të Fehmi e Xhevë Krasniqit – Lladrocit në Drenas

Pjesmarrja e shkollave në aktivitete ka qenë gjithë përfshirëse, ku nxënësit Barazinë Gjinore e kanë filluar nga familja e më tutje në shoqëri, shkollë punë e kështu me radhë (aktivitetet janë edhe në FB të komunës – Komuna Malishevë)



Në bashkëpunim me Rjetin Qeliza kemi mbajtur tri takime – takimi i parë me vajza, takimi i dytë me gra të punësuar dhe takimi i tretë me të rinjë online, me temën “të drejtat e grave nga mardhënja e punës” duke përfshirë sektorin publik dhe privat, të drejtat e tyre para dhe pas mardhënjes së punës, ngacmimet seksuale dhe cënimi i integritetit në të dy sektorët, që nga ngacmimi psikologjik e fizik.



Në bashkëpunim me United Women's Association u mbajt trajnimi për qasje më të lehtë në tregun e punës. Qëllimi i trajnimit ka qenë dhënja e shkathtësive të cilat i atribuohen përgatitjes së Grave për tregun e punës dhe zhvillimin e kapaciteteve të tyre.

Së bashku me Grupin i Grave, vizituan QKMF-në në Malishevë, Kjo vizitë është vazhdimësi e bashkëpunimit me QKMF, në realizimin e ligjëratave nëpër zonat rurale me temën "parandalo para se të mjekosh", ligjëratat të cilat i paraprinë muajit të ndërgjegjësimit për kancerin e gjirit, dhe u liruan nga pjesëmarrja në pagesë në kabinetin e radiologjisë. Drejtori i QKMF-së e njoftoi grupin e grave për shërbimet të cilat ju ofrohen qytetarëve dhe mungesat të cilat i kanë gjatë punës së tyre, si dhe përgaditjen e stafit dhe kabinetit për vendosjen e mamografisë (kërkesë nga grupi i grave).





Në muajin e integritit të personave me nevoja të veçanta mbajtmë tryezën për të drejtat, bashkëpunimin, punësimin, integrimin në shoqëri, si dhe qasjen më të lehtë në institucione të personave në fjalë.

Në kuadër të 16 ditëve të aktivizimit kundër dhunës, janë njoftuar të gjitha shkollat që në lëndën e edukatës qytetare, mësimeve të realizojnë një orë mësimore kushtuar kësaj teme, po ashtu në kuadër të kësaj fushate, logo me fjalë, do të jetë e vendosur në ueb faqen zyrtare të Komunës së Malishevës, vlenë të përmendet se është përgaditur një album duke përfshirë të gjitha aktivitetet e nxënësve.

Janë mbajtur aktivitete të ndryshme nëpër shkolla:





Po ashtu në kuadër të 16 – ditëshit, së bashku me anëtarët e Komitetit për Barazi Gjinore kemi vizituar strehimoren “shtëpia e sigurtë” në Gjakovë, me ç’rast dërguam një ndihmë simbolike dhe u njoftuam me punën, sfidat me të cilat ballafaqohen përgjthë punës së tyre.



Në përfundim të vitit është përgaditur Buletini Informues, i cili përfshinë aktivitetet, bashkëpunimet, iniciativat, rekomandimet lidhur me çështjet gjinore, dhe është prezentuar para asambleistëve.

Të dhënat statistikore në baza gjinore

Komuna e Malishevës ka gjithësejtë 69.656 banorë me numër të përgjithshëm, 27.973 femra dhe 26.683 meshkuj dhe me 15.000 banorë jo rezident.

Prej 11 drejtorive e emëruar është një drejtoreshë (DAP) dhe 3 menaxhere të sektorëve

Prej 41 shkollave amë dhe dy paraleleve kemi 9 drejtoresha

Janë të regjistruara gjithësejt 184 biznese – 29 femra – 155- meshkuj

Në asistencë sociale janë gjithësejt 741.

Institucioni	Nr.i përgjithshëm	Femra	Meshkuj	Përqindja
Komuna	129	22	107	17.05%
Arsimi	1038	386	653	37.18%
Shëndetësia	120	59	61	49.16%
	1,288	467	821	36.25%

	Nr.i përgjithshëm	Femra	Meshkuj	Përqindja
A.Komunale	31	11	20	35.48
KPF	7	2	5	28.57
K.Komunitete	7	3	4	42.85
K.planf.urban	3	2	1	66.00
K. për diasp.	3	2	1	66.00
K.bujq.	3	/	3	0.00
K.ars.kulturë	3	1	2	33.33
K.shëndetësi	3	2	1	66.00
K.fam.deshm.	5	1	4	20.00
K.B.GJ	7	5	2	71.42
	68	29	39	42.64

Në çerdhen “Zërat e ëmbël” vijnë gjithësejtë 83 fëmijë – 39 vajza dhe 44 djem

SHFMU	Nr.ipërgjithshëm	Femra	Meshkuj	Përqindja
Parafillorë	814	378	436	46.43%
I-IX	8297	4038	4259	48.66%
X-XII	1764	1023	741	57.99%
Nx.nev.veç.	3	3	0	100 %
	10,878	5,442	5436	50.02%

Qendra e Kompetencës	Nr.ipërgjithshëm	Femra	Meshkuj	Përqindja
Nr i nxënësve	499	196	303	39.27%

Nr i mësimdhënësve	Nr.ipërgjithshëm	Femra	Meshkuj	Përqindja
Q.Kompetencës	70	15	55	21.42%

Zyrtarja për Barazi Gjinore

Vera Bytyçi
